



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.1805/2018

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli, kryetare e kolegjit, Gani Avdiu dhe Faton Ademi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.B., nga Fushë Kosova, të cilin me autorizim e përfaqëson B.J., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “K...”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson V.R., me bazëjuridike kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesës paditësit dhe të të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3056/2013, të datës 21.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 09.03.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e paditësit N.B. nga Fushë Kosova, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3056/2013 i datës 21.12.2017 në pikën II (II. a, b) të dispozitivit që i referohet dëmit jomaterial dhe gjykohet: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “K...” me seli në Prishtinë që paditësit N.B. nga Fushë Kosova në emër të dëmit jomaterial për shkak të lëndimeve të rënda trupore të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 08.10.2013, t’ia paguaj shumat si në vijim,
 - për dhimbje fizike shumë prej 4000€ (katërmijë euro)
 - për frikë shumë prej 3000€ (tremijë euro), me normën e kamatës të cilën e paguajnë bankat për mjetet e deponuara për një vit, pa destinim të caktuar, e cila llogaritet nga data e ekspertizës 17.11.2017, e deri në pagesën definitive, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë për këto kategori të dëmit përtej shumës së gjykuar refuzohet si e pabazuar.
- II. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e paditësit N.B. nga Fushë Kosova, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3056/2013 i datës 21.12.2017, në pikën III të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë që i referohet dëmit material për përkujdesje dhe ndihmë të personit tjetër dhe ushqimit të përforcuar dhe gjykohet: APROVOHET kërkesëpadia e paditësit N.B. nga Fushë Kosova për ndihmë dhe përkujdesje të personit të tretë në shumë prej 150€ dhe për ushqim të përforcuar në shumë prej

- 200€, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit në emër të ndihmës dhe përkujdesit të personit të tretë përtej shumës së gjykuar refuzohet si e pabazuar.
- III. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit N.B. dhe e të paditurës Kompania e Sigurimeve “K...” me seli në Prishtinë, e parashtruar në drejtim të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3056/2013 i datës 21.12.2017, përkitazi me kompensimin e dëmit jomaterial në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor (në shumën e gjykuar prej 3500€), ndërsa aktgjykimi në këtë pjesë VËRTETOHET.
 - IV. REFUZOHET ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “K...” me seli në Prishtinë lidhur me shpenzimet e procedurës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3056/2013 i datës 21.12.2017 në këtë pjesë VËRTETOHET.
 - V. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit lidhur me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material në emër të shpenzimeve të mjekimit dhe rehabilitimit klimaterik.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.3056/2013, të datës 21.12.2013, ka vendosur si në vijim:

- I. Pjesërisht aprovohet kërkesëpadia e paditësit N.B. nga Fushë Kosova,
- II. Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “K...” me seli në Prishtinë, që paditësit N.B. nga Fushë Kosova, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, t’ia paguaj shumën e mjeteve prej 7.700€ (shtatë mijë e shtatëqind euro), me normën e kamatës të cilën e paguajnë bankat për mjetet e deponuara, për një vit, pa destinim të caktuar, e cila llogaritet nga data e ekspertizës 17.11.2017, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhe atë sikurse vijon:
 - II.a Në emër të dhimbjeve fizike, shumën e mjeteve në lartësinë prej 2.300€.
 - b. Në emër të frikës së përjetuar për jetën e tij shumën e mjeteve në lartësinë prej 1.900€.
 - c. Në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën e mjeteve në lartësinë prej 3.500€.
- III. Refuzohet kërkesëpadia e paditësit N.B. nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “K...” me seli në Prishtinë, t’ia paguaj dëmin mbi shumën e gjykuara dhe atë, në emër të kompensimit të dëmit për dhimbjet fizike shumën prej 12.700€, në emër të frikës 6.600€, në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumën prej 3500€, po ashtu refuzohet kërkesa e paditësit që të detyrohet e paditura që të ia kompensoj në emër të

ndihmës dhe kujdesit të huaj 250€, në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 200€, në emër të rehabilitimit klimaterik shumë prej 800€, në emër të shpenzimeve materiale të shërimit sipas dokumentacionit shumë prej 275€, si kërkesë e pabazuar në ligj.

- IV. Detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.312 €, ne afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësit brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj me aprovimin e kërkesëpadisë së precizuar të paditësit.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i të paditurës ka paraqitur ankesë për shkak të, shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e të paditurës si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar, ndërsa paditësit t'ia kompensoj dëmin në lartësinë e shumës së ofruar nga e paditura, ose aktgjykimin ta prishë dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në gjykatën e shkallës së parë paditësi N.B. nga Fushë Kosova me datë 21.11.2013, ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "K..." me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit material dhe jo material për shkak të lëndimeve të pësuar në aksidentin e komunikacionit, me arsye dhe kërkesë si në padi.

Gjykata e shkallës së parë, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar provat e propozuara nga palët ndërgjyqëse. Pas vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve në procedurë, ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.3056/2013, i datës 21.12.2017, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se nga ekspertiza e komunikacionit (e hartuar nga eksperti B.A.), është konstatuar se shkakatar i aksidentit të komunikacionit të datës 08.10.2013, ka qenë ngasësi i automjetit VW Golf 1J, i siguruar tek e paditura. Mëtej, nga provat materiale, e në veçanti nga ekspertiza mjekësore e hartuar nga Dr. Q.K. – traumatolog dhe Dr. V.S. psikiatër, është konstatuar që si pasojë e aksidentit paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore me pasoja të rënda për shëndetin. Sipas ekspertëve lëndimet trupore manifestohen si: ndrydhje e kraharorit dhe brrylit të majtë; dhe

thyerje shumëfragmentëshe e kapakut të gjurit të djathtë. Si pasojë e aksidentit paditësi ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje për dy minuta (kohë e nevojshme për kthimin e mediatorëve të inflamacionit në gjendje normale); dhimbja fizike të intensitetit të rëndë ka pasur në kohëzgjatje për 6 ditë; të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje 10 ditë, ndërsa dhimbja fizike e intensitetit të ultë është ende prezente. Ka përjetuar frikë primare për disa sekonda (që nënkupton momentin e aksidentimit, kohë brenda të cilës paditësi ka përjetuar ndjenjën e përfundimit fatal); frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje dy ditë; të intensitetit mesatar në kohëzgjatje prej 6 jave dhe frikë sekondare të intensitetit të ultë në kohëzgjatje 6 muaj. Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është në shkallë 10%.. Ndiqja dhe kujdesi i personit tjetër ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje 2 javë; ushqimi i përforcuar për 6 javë, ndërsa rehabilitimi klimaterik dhe fizioterapeutik për 3 javë. Gjykata ka shtuar se pas analizimit të provave të administruara në kuptim të nenit 8 të LPK-së vlerësoi se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, pasi e paditura është përgjegjëse për dëmin i cili i është shkaktuar paditësit, sepse përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit rrjedh nga lidhja e kontratës – policës së sigurimit me të cilën e paditura ka marrë përgjegjësinë për dëmet e shkaktuara personave të tretë nga i siguruari i saj. Rrjedhimisht, në kuptim të nenit 1.5 të Rregullës 3 të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, nenit 154, 155, 173, 174, 178, 200 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve vlerësoi detyrimin e të paditurës për kompensimin e dëmit. Lidhur me pjesën e refuzuar të kërkesëpadiës përtej shumave të gjykuara, arsyetoi se kërkesa nuk është ekuivalente me pasojat e lëndimeve. Sa i përket vendimit për refuzimin e kërkesëpadiës për kompensimin e dëmit në emër të ndihmës së personit të tretë, ushqimit të përforcuar, rehabilitimit klimaterik dhe shpenzimeve të mjekimit, gjykata arsyetoi se kërkesëpadia në këtë pjesë është refuzuar, meqë paditësi nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilën vërtetohet dëmi konkret. Vendimin për shpenzimet e procedurës e mbështeti në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, e në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 al.2, pika n), pasi aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, i njëjti është i qartë dhe përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadiës. Në këtë kuptim, pretendimet e të paditurës si në ankesë për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sipas vlerësimit të gjykatës ankimore janë të pabazuara, pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse, të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Për më shumë, faktet vendimtare të rastit në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk kanë qenë kontestues për të paditurën, sikurse që është shkaktimi i aksidentit në komunikacion nga i

siguruari i të paditurës dhe poashtu që si pasojë e këtij aksidentit, paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore të konstatuar si në ekspertizën mjekësore, përkatësisht baza juridike e kërkesëpadisë është vërtetuar me prova materiale që gjenden në shkresat e lëndës dhe atë nga Raporti i Policisë dhe ekspertiza e komunikacionit, e të cilat prova nuk janë kontestuar nga e paditura. Ndërsa lartësia e kërkesëpadisë është vërtetuar mbi bazën e ekspertizës mjekësore në të cilën është konstatuar natyra e lëndimit dhe pasojat e lëndimit të paditësi, përfshirë intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike dhe të frikës, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit jetësor dhe nevojën për ndihmën e huaj dhe ushqimin e përforcuar.

Gjykata e Apelit pjesërisht i pranon pretendimet ankimore të paditësit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke pranuar pjesërisht ankesën e paditësit, sepse vendimi i gjykatës së shkallës së parë sa i përket të drejtës materiale nuk ishte në harmoni me gjendjen faktike të konstatuar në procedurën e të provuarit, andaj aktgjykimin e shkallës së parë në pjesën e kërkesëpadisë për kompensim të dëmit jomaterial dhe material për paditësin e ka ndryshuar, duke vendosur si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, komform nenit 195 par. 1 pika e) të LPK-së dhe e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj për dhimbje fizike shumë prej 4000€ dhe për frikë shumë prej 3000€, për ndihmë dhe përkujdes të personit të tretë shumë prej 150€ dhe për ushqim të përforcuar shumë prej 200€. Vendimin për ndryshimin e lartësisë së kompensimit në emër të dëmit jomaterial gjykata e ka mbështetur në ekspertizën mjekësore nga e cila ka rezultuar se paditësi ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë dhe të intensitetit të rëndë, me dëmtim të shëndetit me pasoja të përhershme, si dhe frikë primare dhe sekondare. Marrë parasysh intensitetin e dhimbjeve dhe frikës së përjetuar nga paditësi, kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar se shumtë e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë- nuk ishin në harmoni me qëllimin e kompensimit për dëmin jo material. Prandaj, me ndryshimin e aktgjykimit në këtë pjesë, kjo gjykatë vlerëson se përmbushet qëllimi i kompensimit si lloj satisfaksioni për palën e dëmtuar për zbutjen e dhimbjeve dhe pasojave të shkakuar nga aksidenti i komunikacionit, (të cilit nuk i ka kontribuar paditësi), dhe ky lloj kompensimi është në harmoni me dispozitat e nenit 200 të LMD (1978), respektivisht dispozitivin e nenit 183 të LMD (Ligji Nr. 04/L-077). Pjesa tjetër përtej shumës së gjykuar është refuzuar si e pabazuar, ngase është në disproporcion me të mirën e shkelur dhe qëllimin e kompensimit.

Gjykata e Apelit pjesërisht ka pranuar pretendimet ankimore të palës paditëse për zbatim të gabuar të së drejtës materiale lidhur me kërkesëpadinë e refuzuar në emër të ndihmës dhe përkujdesit të personit tjetër dhe ushqimit të përforcuar, pasi vetë kërkesa për ushqim të përforcuar dhe ndihmën e personit të tretë pranohet pavarësisht nga provat për të provuar lartësinë, sepse sipas standardeve të praktikës gjyqësore për këto dy kategori të dëmit pranohet një shumë mesatare (10€ për përkujdes të personit të tretë, respektivisht 5€ për ushqim të përforcuar) nga shkak se këto dy kategori të dëmit si shërbime merren brenda familjes, andaj edhe është e vështirë të sigurohen prova për lartësinë. Në rastin konkret me ekspertizë mjekësore është konstatuar nevoja që paditësi ka pasur për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej gjashtë javë dhe po ashtu nevoja për ndihmën e personit të tretë në kohëzgjatje prej dy javë, andaj gjykata ankimore mbi këtë konstatim të ekspertit dhe sipas

standardeve të praktikës ka vendosur për ndryshimin e aktgjykimit, me ç'rast është pranuar kompensimi në shumën e gjykuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar si të pabazuar pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqëse përkitazi me shumën e gjykuar në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, pasi në këtë pjesë gjykata e shkallës së parë vendimin e ka bazuar në ekspertizën mjekësore nga e cila ka rezultuar se shkalla e aftësisë së zvogëluar të paditësi është 10% dhe rrjedhimisht me vlerësimin e rrethanave tjera si moshë e paditësit në kohën e aksidentimit dhe kriterëve tjera përcaktuese, kompensimi në shumë 3500€, në emër të këtij dëmi, pranohet si kompensim adekuat edhe nga gjykata e shkallës së dytë, meqë kjo mënyrë e vendosjes është në harmoni me praktikën gjyqësore ndërsa me këtë formë të kompensimit do të zbuten pasojat që janë shfaqur për shkak të cenimit të integritetit fizik e psikik tek paditësi.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit pasi që ka vlerësuar se vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së, andaj edhe është vërtetuar aktgjykimi në këtë pjesë.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën V të këtij aktgjykimi dhe ka vendosur që të mos e shqyrtojë aktgjykimin e atakuar në pjesën e kërkesëpadisë së refuzuar për kompensimin e dëmit material në emër të rehabilitimit klimaterik dhe shpenzimeve të mjekimit sepse ankesa e paditësit nuk ishte e drejtuar ndaj aktgjykimit në atë pjesë.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e) e lidhur 201 pika (d) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1805/2018, me datë 09.03.2021

Kryetarja e Kolegjit – Gjyqtarja
Hunaida Pasuli